

KONTRATË SHITBLERJE
KUOTASH KAPITALI

Sot më datë 27.02.2023 (dymijë e njëzet e tre), palët kontraktuese ranë dakord për hartimin e kësaj kontrate shitblerje kuotash kapitali, në bazë të dispozitave të Kodit Civil, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar), statutit të shoqërisë "BIO DERMA" SHPK, Vendimit datë 24.02.2023 të shoqërisë "DELTA HOLDING" SHPK, Vendimit datë 24.02.2023 të shoqërisë "BIO DERMA" SHPK me kushtet e mëposhtme:

Neni 1

Palët

Pala Shitëse:

1) **znj. Jorida Jubani**, shtetase shqiptare, lindur më 04.06.1980 në Shkodër dhe banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e pasaportës nr. BF5378201 dhe numër personal I05604127T.

2) **znj. Marjana Curraj**, shtetase shqiptare, lindur më 11.02.1979 në Ivanaj dhe banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit nr. 033871238 dhe numër personal H95211035K.

Dhënës Pëlqimi:

1) **z. Dorian Sadiku**, shtetas shqiptar, lindur më 20.06.1979, në Shkodër dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportës nr. BF5378227 dhe nr. Personal H90620115D, në cilësinë e bashkëshortit të znj. Jorida Jubani.

2) **z. Eduard Curraj**, shtetas shqiptar, lindur më 13.10.1973 në Jeran dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit nr. 033871246 dhe nr. personal H31013028R, në cilësinë e bashkëshortit të znj. Marjana Curraj.

Pala Blerëse:

Shoqëria "DELTA HOLDING" SHPK, shoqëri tregtare, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) më datë 16.01.2023, me NUIS (NIPT) M31316015P, me zyrë qendrore në Tiranë, Autostrada Tiranë – Durrës, km. 3, Zona Kadastrale 2679, nr.pasurie 19/27/1, Mëzez, Kashar, e përfaqësuar nga administratori znj. **Ewa Maria Kokot**, lindur me 18.05.1962, ne Czestochowa, Poloni, dhe rezidente në Shqipëri, në adresën rruga "Tish Daia", hyrja 2, ap. 49, Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e pasaportës nr. EL5804363 dhe numër personal 62051804767.

Kushtet Paraprake

- Shoqëria "BIO DERMA" SHPK, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, është regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në datë 27.03.2019, e pajisur me Certifikatë Regjistrimi NUIS (NIPT) L91527016U; me zyrë qendrore në Tiranë, rruga "Asim Zeneli", Apartamenti nr. 2, zona kadastrale 8160, nr. pasurie 2/128; me kapital të regjistruar 100,000 (njëqind mijë) lekë; me ortakë znj. Jorida Jubani, zotëruese e 1 (një) kuote, e cila përbën 33.33% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe znj. Marjana Curraj, zotëruese e 1 (një) kuote, e cila përbën 66.67% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë;
- Pala shitëse do të shesë kuotat të cilat përfaqësojnë 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "BIO DERMA" SHPK dhe pala blerëse do të blejë këtë kuotë;



- Palët paraprakisht kanë rënë dakord që çmimi i kësaj kontrate do të paguhet nga pala blerëse brenda 30 ditëve nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate;

Për sa më lart palët bien dakord, për sa vijon:

Neni 2

Objekti

2.1 Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse znj. Jorida Jubani, i shet palës blerëse shoqëria "DELTA HOLDING" SHPK, kuotën që ajo zotëron në shoqërinë "BIO DERMA" SHPK dhe e cila përbën 33.33% të kapitalit të kësaj shoqërie.

2.2 Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse znj. Marjana Curraj, i shet palës blerëse shoqëria "DELTA HOLDING" SHPK, kuotën që ajo zotëron në shoqërinë "BIO DERMA" SHPK dhe e cila përbën 66.67% të kapitalit të kësaj shoqërie

Neni 3

Çmimi

3.1 Palët bien dakord që çmimi i shitjes së kuotave që znj. Jorida Jubani dhe znj. Marjana Curraj zotërojnë në shoqërinë "BIO DERMA" SHPK, objekt i kësaj kontrate, është në total 100,000 (njëqind mijë) lekë. Palët bien dakord që çmimi i shitjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate.

3.2 Shuma e mësipërme do të likuidohet nga pala blerëse shoqëria "DELTA HOLDING" SHPK, në llogarinë bankare të komunikuar nga pala shitëse Jorida Jubani dhe Marjana Curraj, sipas vlerës respektive 33,330 (tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë) lekë për znj. Jorida Jubani dhe 66,670 (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë për znj. Marjana Curraj.

Neni 4

Të Drejta dhe Detyrime të Palëve

4.1 Palët bien dakord që pas kalimit të kuotës nga pala shitëse, znj. Jorida Jubani do të vazhdojë të jetë administratore e shoqërisë "BIO DERMA" SHPK.

4.2 Pala blerëse detyrohet të paguajë çmimin e kontratës, brenda afatit të përcaktuar në pikën 3.1 të kësaj kontrate.

4.3 Palët kësaj kontrate detyrohen që asnjëra prej tyre të mos tërhiqet nga kjo kontratë. Në rast se ndonjëra prej palëve tërhiqet nga kontrata apo kryen ndonjë veprim me qëllim mosplotësimin e kushteve të përcaktuara në dispozitat e kësaj kontrate, atëherë pala që tërhiqet ose kryen veprimin, detyrohet t'i paguajë palës tjetër dëmin e shkaktuar dhe fitimin e munguar.

Neni 5

Kalimi i Pronësisë

5.1 Palët kanë rënë dakord që kjo kontratë shitblerje kuotash kapitali, pavarësisht se çmimi i saj do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e nënshkrimit të kontratës, do të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe shoqëria "DELTA HOLDING" SHPK do të bëhet ortakë në shoqërinë "BIO DERMA" SHPK, duke zotëruar 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

5.2 Në momentin e regjistrimit të kësaj kontrate sipas nenin 5.1, pronësia mbi kuotën e cila përbën 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "BIO DERMA" SHPK, do të kalojë nga pala shitëse znj. Jorida Jubani dhe znj. Marjana Curraj, tek pala blerëse shoqëria "DELTA HOLDING" SHPK.

5.3 Nga momenti i regjistrimit të kësaj kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) pala shitëse, humbet çdo të drejtë mbi kuotën e cila përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërinë "BIO DERMA" SHPK dhe këto të drejta fitohen nga pala blerëse, shoqëria "DELTA HOLDING" SHPK.

Neni 6

Dhënësi i Pëlqimit

6.1 Dhënësi i pëlqimit z. Dorian Sadiku, bashkëshort i ortakut Jorida Jubani dhe bashkëpronar për efekt martese në kuotën që znj. Jorida Jubani zotëron në shoqërinë "BIO DERMA" SHPK, deklaroi se është dakord që kuota, objekt i kësaj kontrate, në pronësi të bashkëshortes së tij, t'i shitet shoqërisë "DELTA HOLDING" SHPK.

Dhënësi i pëlqimit deklaroi se nuk ka asnjë pretendim lidhur me këtë vendimmarrje të bashkëshortes së tij për shitjen e kuotës dhe nuk do ketë asnjë pretendim në të ardhmen lidhur me këtë shitje dhe me sa është deklaruar e rënë dakord midis palëve në këtë kontratë, apo me çdo vendimmarrje tjetër që znj. Jorida Jubani po ndërmerr e do ndërmarrë, në marrëdhënien tregtare me shoqërinë "DELTA HOLDING" SHPK.

6.2 Dhënësi i pëlqimit z. Eduard Curraj, bashkëshort i ortakut Marjana Curraj dhe bashkëpronar për efekt martese në kuotën që znj. Marjana Curraj zotëron në shoqërinë "BIO DERMA" SHPK, deklaroi se është dakord që kuota, objekt i kësaj kontrate, në pronësi të bashkëshortes së tij, t'i shitet shoqërisë "DELTA HOLDING" SHPK.

Dhënësi i pëlqimit deklaroi se nuk ka asnjë pretendim lidhur me këtë vendimmarrje të bashkëshortes së tij për shitjen e kuotës dhe nuk do ketë asnjë pretendim në të ardhmen lidhur me këtë shitje dhe me sa është deklaruar e rënë dakord midis palëve në këtë kontratë, apo me çdo vendimmarrje tjetër që znj. Marjana Curraj po ndërmerr e do ndërmarrë, në marrëdhënien tregtare me shoqërinë "DELTA HOLDING" SHPK.

Kjo kontratë hartohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe, nga të cilat një origjinal regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe më pas qëndron në zyrën qendrore të shoqërisë dhe nga një origjinal e merr secila palë.

Kjo kontratë pasi u lexua me zë të lartë prej palëve, ata deklaruan që ajo është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë e të pavesuar dhe e nënshkruajnë atë rregullisht. Zonjës Ewa Maria Kokot kjo kontratë iu përkthye në gjuhën angleze nga Lindita Tema, person i besuar prej saj.

PALA SHITËSE

JORIDA JUBANI

Jorida Jubani
Jubani

MARJANA CURRAJ

Marjana Curraj
Curraj

DHËNËSI I PËLQIMIT

DORIAN SADIKU

Dorian Sadiku
Sadiku

PALA BLERËSE

SHOQËRIA "DELTA HOLDING" SHPK

përfaqësuar nga administratori
EWA MARIA KOKOT

Ewa Kokot
Ewa Kokot



DHËNËSI I PËLQIMIT

EDUARD CURRAJ

Eduard Curraj
Curraj

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË
“DELTA HOLDING” SHPK

Sot, në datën 24.02.2023, në përputhje me parashikimet e Statutit të shoqërisë “DELTA HOLDING” SHPK, shoqëri e së drejtës shqiptare, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), me NUIS (NIPT) M31316015P, me zyrë qendrore në adresën Autostrada Tiranë – Durrës, km. 3, zona kadastrale 2679, nr. pasurie 19/27/1, Mezëz, Kashar, Tiranë, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë, mbledhje e thirrur nga administratorit i shoqërisë, në përputhje me dispozitat e statutit të shoqërisë dhe nenin 83 paragrafi i fundit të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar) .

Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme janë prezent ortakët e shoqërisë të cilët përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë:

- z. Dorian Sadiku, zotërues i 1 (një) kuote e cila përfaqëson 50 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë;
- z. Eduard Curraj, zotërues i 1 (një) kuote e cila përfaqëson 50 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

Mbledhja mori në shqyrtim çështjet e rendit të ditës si më poshtë vijon:

- blerjen nga shoqëria “DELTA HOLDING” SHPK të kuotave të zotëruara nga znj. Jorida Jubani dhe znj. Marjana Curraj në shoqërinë “BIO DERMA” SHPK;
- përcaktimin e çmimit të blerjes, pagimin e këtij çmimi, kalimin e kuotës dhe të drejtat e detyrimit e palëve, sipas tekstit të kontratës bashkëlidhur këtij vendimi;
- autorizimin e administratorit të shoqërisë për nënshkrimin e kontratës së shitblerjes;
- të ndryshme.


Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës dhe të dokumentacionit përkatës, Asambleja e Përgjithshme me unanimitet:

V E N D O S I

- 1) Blerjen nga shoqëria “DELTA HOLDING” SHPK të kuotave të zotëruara nga znj. Jorida Jubani dhe znj. Marjana Curraj në shoqërinë “BIO DERMA” SHPK, të cilat përbëjnë 100% të kapitalit të kësaj shoqërie.
- 2) Çmimi i blerjes së kuotave do të jetë në total në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë, ku 33,300 (tridhjetë e tre mijë e treqind) lekë do të jetë çmimi që do t'i paguhet znj. Jorida Jubani dhe 66,670 (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë do të jetë çmimi që do t'i paguhet znj. Marjana Curraj. Çmimi do të paguhet brenda një afati 30 ditor nga dita e nënshkrimit të kontratës.
- 3) Miratimin e tekstit të kontratës së shitblerjes së kuotës, sipas drafutit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- 4) Autorizohet administratori i shoqërisë “DELTA HOLDING” SHPK. znj. Ewa Maria Kokot që të nënshkruajë për emër dhe llogari të shoqërisë, kontratën e shitblerjes së kuotës të miratuar sipas pikës 3 të këtij vendimi.
- 5) Ngarkohet administratori i shoqërisë “DELTA HOLDING” SHPK, që në respektim të zbatimit të këtij vendimit, të kryejë vetë personalisht ose nga persona të tjerë të autorizuar prej tij, të gjithë veprimet e nevojshme administrative për regjistrimin e këtij vendimi dhe dokumentacionit tjetër përkatës pranë institucioneve kompetente shtetërore.


ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME (ORTAKËT)

DORIAN SADIKU

Dorian Sadiku




EDUARD CURRAJ

Eduard Curraj




VENDIM I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË "BIO DERMA" SHPK

Sot, në datën 24.02.2023, në përputhje me parashikimet e Statutit të shoqërisë "BIO DERMA" SHPK, shoqëri e së drejtës shqiptare, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), me NUIS (NIPT) L91527016U, me zyrë qendrore në rruga "Asim Zeneli", Apartamenti nr. 2, zona kadastrale 8160, nr. pasurie 2/128, Tiranë, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të Vetëm) të shoqërisë, mbledhje e thirrur nga administratorit i shoqërisë, në përputhje me dispozitat e statutit të shoqërisë dhe nenin 83 paragrafi i fundit të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar).

Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme janë prezent ortakët e shoqërisë të cilët përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë:

- znj. Jorida Jubani, zotëruese e 1 (një) kuote, e cila përfaqëson 33.33 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë;
- znj. Marjana Curraj, zotëruese e 1 (një) kuote, e cila përfaqëson 66.67 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

Mbledhja mori në shqyrtim çështjet e rendit të ditës si më poshtë vijon:

- shitjen kuotës të zotëruar nga ortaku Jorida Jubani në shoqërinë "BIO DERMA" SHPK tek blerësi shoqëria "DELTA HOLDING" SHPK;
- shitjen kuotës të zotëruar nga ortaku Marjana Curraj në shoqërinë "BIO DERMA" SHPK tek blerësi shoqëria "DELTA HOLDING" SHPK;
- përcaktimin e çmimit të blerjes,
- miratimin e tekstit të kontratës bashkëlidhur këtij vendimi;
- të ndryshme.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës dhe të dokumentacionit përkatës, Asambleja e Përgjithshme me unanimitet:

V E N D O S I

- 1) Shitjen e kuotës të zotëruar nga znj. Jorida Jubani në shoqërinë "BIO DERMA" SHPK, e cila përbën 33.33% të kapitalit të kësaj shoqërie, tek blerësi shoqëria "DELTA HOLDING" SHPK.
- 2) Shitjen e kuotës të zotëruar nga znj. Marjana Curraj në shoqërinë "BIO DERMA" SHPK, e cila përbën 66.67% të kapitalit të kësaj shoqërie, tek blerësi shoqëria "DELTA HOLDING" SHPK.
- 3) Çmimi i shitjes së kuotave do të jetë në total në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë, ku 33,300 (tridhjetë e tre mijë e treqind) lekë do të jetë pjesa e çmimit që do të paguhet ortakut znj. Jorida Jubani dhe 66,670 (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë do të jetë pjesa e çmimit që do të paguhet ortakut znj. Marjana Curraj.
- 4) Miratimin e tekstit të kontratës së shitblerjes së kuotës, sipas draftit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- 5) Ngarkohet administratori i shoqërisë "BIO DERMA" SHPK, që në respektim të zbatimit të këtij vendimit, të kryejë vetë personalisht ose nga persona të tjerë të autorizuar prej tij, të gjithë veprimet e nevojshme administrative për regjistrimin e këtij vendimi dhe dokumentacionit tjetër përkatës pranë institucioneve kompetente shtetërore.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

JORIDA JUBANI



MARJANA CURRAJ